



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROJEKTLIGJ**

NR \_\_\_\_/2019

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010 "PËR  
INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZIMIT NË  
SHQIPËRI"**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,  
me propozimin e një grupi deputetësh

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizimit në Shqipëri", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 11, pika 1, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Shkronja ç ndryshohet me këtë përmbajtje:

"ç. propozon në Kuvendin e Shqipërisë strukturën dhe organikën e institucionit;

2. Pas shkronjës ç shtohet shkronja ç/1 me këtë përmbajtje:

"ç/1. propozon në Këshillin e Ministrave buxhetin vjetor të institucionit;"

**Neni 2**

Në nenin 19, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Struktura dhe organika e punonjësve të institutit miratohen me vendim të Kuvendit të Shqipërisë."

### **Neni 3**

#### **Dispozitë kalimtare**

Ngarkohet Kuvendi i Shqipërisë të miratojë strukturën dhe organikën e Institutit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 të këtij ligji brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji..

### **Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**GRAMOZ RUÇI**